



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3110/ 14 prot.

Datë 24.01.2024

V E N D I M
Nr. 90 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 26/2024, datë 09.01.2024, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-88685-11-22-2023, me objekt “Blerje dru zjarri dhe Pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ALCANI” SHPK me Nipt J91505006Q
Adresa: Rruga e Laknasit, Blloku Frutikulturë 100 m pranë urës, Kamëz.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Rrogozhinë.
Adresa: Lagjja 1, Rruga e Kavajës.
- Subjekt i Interesuar** Operatori ekonomik “Gjergj Buça” P.F me NIPT K31331547R
dhe adresë “Ura Dajlanit” Durrës.
- Baza Ligjore:** Ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021

“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.26/2024 ku vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ALCANI” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-88685-11-22-2023, me objekt “Blerje dru zjarri dhe Pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.*
- 2. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “ALCANI” SHPK duke e kualifikuar këtë operator sipas konstatimeve të mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALCANI” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 220 prot., datë 16.01.2024, protokolluar me tonën nr. 3110/11 prot., datë 19.01.2024 me objekt “Zbatim vendimi” autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë, informon se ka zbatuar vendimin Nr.26/2024, datë 09.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 220 prot., datë 16.01.2024, protokolluar me tonën nr. 3110/11 prot., datë 19.01.2024 me objekt “Zbatim vendimi” autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë, informon se ka zbatuar vendimin Nr.26/2024, datë 09.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Referuar shkresës, AK ka kryer rivlerësim të ofertave pas Vendimit të KPP-së.për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-88685-11-22-2023, me objekt “Blerje dru zjarri dhe Pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.

II.2. Sa më sipër, nga verifikimet në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Komisioni konstatoi se autoriteti kontraktor Bashkia Rrogozhinë ka kryer rivlerësim të ofertave më datë 19.01.2024, në zbatim të vendimit Nr.26/2024, datë 09.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapa të mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-88685-11-22-2023, me objekt “Blerje dru zjarri dhe Pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

